



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror
Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja Nr. 44
Prishtinë, më 5.10.2010, ora 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Sanije Aliaj, Rexhep Hoti, Numan Balić, Xhevdet Neziraj, Zylfi Merxha, Dragiša Mirić, Enis Kervan, Hetem Arifi Sadik Idriz dhe Hafize Hajdini dhe Mursel Haljilji.

Munguan: Petar Miletić dhe Müfera Şinik.

Në mbledhje prezantuan: përfaqësueset nga OSB-ja Elita Vokshi, Lejla Selimi, përfaqësuesi nga KDI Liridon Selmani dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Nga Stafi Mbështetës: Natasa Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Sanije Aliaj, Zëvendëskryetarja e parë e Komisionit

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Themelimin e Sistemit për Sigurimin e dispozitave për Institucionet Financiare në Kosove – Komisioni për Buxhet dhe Financa, me amendamente;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente;

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L 186 për Energjinë Elektrike me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente;

Kryesuesja-konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja - e hapi mbledhjen e sotme dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit që i njëjti të plotësohet me pikën 7. shqyrtimi i Projektligjit për Regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave.

Propozimi për plotësim të rendit të ditës, unanimisht u miratua nga anëtarët e komisionit.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;

Kryesuesja, konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, me shumicë votash, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. . Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës dhe ka konstatuar se projektligji me amendamente nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Themelimin e Sistemit për Sigurimin e dispozitave për Institucionet Financiare në Kosovë – Komisioni për Buxhet dhe Financa, me amendamente;

Kryesuesja, konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, me shumicë votash, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Themelimin e Sistemit për Sigurimin e dispozitave për Institucionet Financiare në Kosovë dhe ka konstatuar se projektligji me amendamente nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente;

Kryesuesja, konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, me shumicë votash, nxori këtë;

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë dhe ka konstatuar se projektligji me amendamente nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente;

Kryesuesja, konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara dhe nxori këtë;

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe ka konstatuar se projektligji me amendamente nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L 186 për Energjinë Elektrike, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente;

Kryesuesja, konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, me shumicë votash, nxori këtë;

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 03/L 186 për Energjinë Elektrike dhe ka konstatuar se projektligji me amendamente nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

7. Shqyrtimi i Projektligjit për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe të Banesave, me raportin e komisionit funksional nr. 03/L-237 – Komisionit për Administratën Publike, Pushtetin Lokal dhe Media, me amendamente;

Kryesuesja, lidhur me këtë pikë ajo propozoi se amendamenti 10 (nenin 14,1,5) i komisionit funksional, në tekst ‘sipas gjuhëve në Kosovë’ të zëvendësohet me fjalën ‘në gjuhët zyrtare komfor Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në Kosovë’ dhe se i njëjti i plotëson kriteret si amendament. Në vazhdim tha se para nesh është edhe propozimi i përfaqësuesve të grupit KDTP, lidhur me këtë pikë fjalën ia dha Enis Kervan.

Enis Kervan- në fjalinë e tij tha se amendamenti i komisionit funksional ‘në gjuhën zyrtare komfor Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve’ të cilat kanë të bëjnë me aspektin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve në procesin e regjistrimit të popullsisë, do të ketë paqartësi kur është fjala për zbatimin e gjuhës turke nëpër komuna

Lidhur me këtë çështje, ai tha se në komunën e Prizrenit dhe në Mamush gjuha turke është gjuhë zyrtare e barabartë me gjuhën shqipe dhe serbe, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në bazë të Ligjit për përdorim të Gjuhëve.

Ai ngriti çështjen se në nivel komunal - në Komunën e Prishtinës, Gjilanit, Vushtrrisë dhe Mitrovicës, gjuha turke është votuar dhe pranuar si gjuhë zyrtare në përdorim, ndërsa në këtë kontekst nuk është nxjerr status dhe as rregullore.

Në vazhdim tha se është informuar nga ICO, se në mbështetje të Komisionit Evropian janë shtypur formularët në tri gjuhë, në gjuhën shqipe, në gjuhën serbe janë shtypur në gjuhën latine- për arsye të komunitetit boshnjak dhe në gjuhën turke.

Lidhur me çështjet e ngritura, ai propozoi të votohet amendamenti i grupit KDTP, me tekstin si vijon:

‘Organizon punën për dizajnimin dhe shtypjen e pyetësorëve, të udhëzimeve metodologjike, të hartuara të qarqeve regjistruese, pajisjet e parapara (logot dhe kartelat identifikuese, shënim tjetër kapelë, fanellë apo tjetër, llojet e pyetësorëve në gjuhën shqipe serbe dhe turke’

Numan Balić- e përkrah propozimin e zot. Enis që në Projektligj të shtohet fjala ‘ në gjuhët zyrtare nëpër komuna’.

Në diskutimin e tij dha sqarim se $\frac{3}{4}$ e komuniteti boshnjak dhe goran , të cilët për një vit kanë jetuar jashtë shtetit ju mohohet mundësia që të regjistrohen si rezident të Kosovës. Andaj propozoi që në Projektligj të fshihet fjala ‘një vit’.

Shprehu qëndrimin e tij se Projektligji për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe të Banesave është i një rëndësie të veçantë për komunitet, andaj propozoi që kjo pikë të shtyhet për një mbledhje të radhës ku secili nga anëtarët e komisioni do të dalë me propozime konkrete.

Rexhep Hoti – në fjalinë e tij tha se nuk pajtohet me propozimin e Enis Kervan, sepse amendamenti i KDTP-së do të krijojë situatë tendencioze në kuadër të Ligjeve të miratuara në Kosovë. Ai theksoi se në gjuhën zyrtare formularët do të shtypen komfor Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ndërsa pajtohet që në amendamentin 10 të komisionit funksional, të shtohet formulimi ‘ në gjuhë zyrtare në komuna’. Ai u pajtua që shqyrtimi i këtij projektligji të shtyhet për mbledhje të radhës.

Xhevdet Neziraj- në fjalën e tij tha se të gjitha komunitetet kanë arritur prioritet me zgjedhjen e Pavarësisë së Kosovës. Ai theksoi se Kushtetuta dhe ligji janë bazë për zgjedhjen e regjistrimit të komunitetit shumicë dhe atij pakicë, por mendon se ekziston problemi vetëm te komunitetit pakicë sepse mund të bëhen manipulime gjatë procesit të regjistrimit.

Kryesuesja, konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

PËRFUNDIM

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në mbledhjen e mbajtur më 5.10.2010 ka shqyrtuar Raportin e Komisionit për Administratën Publike, Pushtetin Lokal dhe Media me amendamentet në Projektligjin për Regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave dhe ka kërkuar kohë shtesë (7 ditë) për të analizuar amendamentet, që kanë të bëjnë me aspektin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve në procesin e regjistrimit të popullsisë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Zëvendëskryetarja e parë Komisionit

Sanije Aliaj